

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “RIFINANCIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË ZONAT URBANE DHE RURALE, FAZA E DYTË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.86/2015”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është shfuqizimi dhe denoncimi i marrëveshjes së nënshkruar në datën 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, të miratuar me ligjin nr.86/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”.

Nga momenti i dekretimit të marrëveshjes qeveritare dhe deri më sot marrëveshja nuk është bërë efektive asnjëherë.

Pala gjermane, nëpërmjet kanaleve diplomatike, ka propozuar një projekt marrëveshje të re për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive”, duke vënë në dispozicion një shumë financimi në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) euro, duke mbështetur dhe promovuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Ky projektligj nuk është i parashikuar në programin analitik të Këshillit të Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kjo projekt marrëveshje ishte parashikuar të zbatohet nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe do të monitorohej nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* (KfW). Gjatë periudhës shtator 2015-2016, KfW-ja ka kontaktuar periodikisht bankat e nivelit të dytë për të mundësuar bërjen efektive të linjës së kredisë, por pa sukses, pasi në të gjitha takimet është evidentuar fakti që bankat nuk kanë mangësi likuiditeti, por ata propozuan nevojën e krijimit të një fondi të veçantë garancie për kreditimin e SME-ve. Ndërkohë në nenin 1, të marrëveshjes qeveritare, të ratifikuar me ligjin nr.86/2015, përcaktohet se: “Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera”.

Në pamundësi të vënies në zbatim të këtij projekti nëpërmjet sistemit bankar, një delegacion i KfW-së u takua me përfaqësues të ish-MZHETTS-së (MFE) në maj të vitit 2016, ku u ra dakord që KfW-ja të bëjë një studim mbi nevojat e sektorit bankar, për periudhën nëntor 2016 – janar 2017. Ky studim evidentoi faktin se në Shqipëri pengesa më e madhe për dhënien e kredive nuk është mungesa e mjeteve financiare të bankave të nivelit të dytë, por mungesa e garancive nga ana e kredimarrësve (SME).

Duke u bazuar në përfundimet e studimit dhe në ndryshimin e kushteve të përgjithshme të projektit, u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë dhe të KfW-së dhe të MZHETTS-së në shtator 2017, ku u diskutua për mundësinë e promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes një instrumenti tjetër – atë të Fondit të Garancisë së Kredive Rurale (RCGF). Por ky instrument nuk mund të zbatohet sepse nuk ishte i parashikuar në kushtet e marrëveshjes, të miratuar në ligjin nr.86/2015. Në këto kushte, kjo marrëveshje nuk u zbatua kurrë dhe nuk ka pasur asnjë disbursim fondesh.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ka planifikuar sikurse është përcaktuar edhe në protokollin e konsultimeve qeveritare gjermano-shqiptare mbi bashkëpunimin për zhvillim, datë 12 dhjetor 2017, të vërë në dispozicion në kuadër të bashkëpunimit financiar përmes bankës gjermane për rindërtim KfW, një shumë financimi në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) euro, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale (RCGF)”. Realizimi i këtij projekti kushtëzohet nga lidhja e një marrëveshjeje të re, ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Financimi i projektit të përshkruar më sipër shkon në ngarkim të mjeteve financiare që Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë i janë premtuar

tanimë në mënyrë të detyrueshme, sipas së drejtës ndërkombëtare për projekte të tjera, por që prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nuk janë përdorur.

Në mënyrë që këto mjete financiare të mund të disponohen sërish, Republika Federale e Gjermanisë propozon:

1. Anulimin me dakordësi të ndërsjellë të marrëveshjes së nënshkruar në datën 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, të miratuar me ligjin nr.86/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”.
2. Marrëveshje e sipërpërmendur shfuqizohet në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet e brendshme për shfuqizimin e saj. Përcaktuese mbetet dita e marrjes së njoftimit nga autoritetet shqiptare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron me ndonjë akt ligjor të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar përmban 2 nene.

Neni 1 parashikon denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi të këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit për “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”, ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektmarrëveshja nuk parashikon asnjë efekt financiar apo garanci pasurore nga shteti.

KËSHILLI I MINISTRAVE